



### Takim me Ambasadorin Britanik në Shqipëri Z. Alastair King-Smith

Gjatë takimit u diskutua mbi mundësitë e rritjes së bashkëpunimit midis Universitetit të Elbasanit, Ambasadës Britanike në Shqipëri dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë në Britani. Rektori u ndal në rëndësinë e zhvillimit të arsimit të lartë, përmes implementimit të bashkëpunimeve konkrete, duke përmendur këtu, krijimin e programeve të përbashkëta, pjesëmarrjen në projekte, zhvillimin e leksioneve të hapura për studentët nga ekspertë britanikë, rritjen e mobiliteteve akademike, si dhe ndryshimi i narrativës së të rinjve lidhur me emigracionin. Në kuadër të vizitës së tij, Z. King-Smith, zhvilloi edhe një takim me studentët, ku u diskutuan çështje të lidhura me studentët dhe zhvillimin akademik të tyre.

### Premiera "Profesionisti"



Të ftuarit ndanë me studentët dhe pedagogët vlerat e kësaj premiere, kujtimet e roleve të tyre, marrëdhënia e artistit dhe publikut me artin, sfidat e teatrit dhe filmi shqiptar, pa harruar së përmenduri edhe plejadën e artistëve që u kanë dhënë jetë me krijmtarinë e tyre shumë personazheve. Gjithashtu, përfituan nga ky takim për të dhënë këshilla të vlefshme mbi përfshirjen e dramaturgjisë shqiptare në kurrikula, si një pasuri historike, kulturore e shoqërore, vazhdimësia e së cilës varet nga interesi dhe vlerësimi i brezave të rinj për të mos e lënë në harresë.

### Gjimnazi "Dhaskal Todri" në UE



Universiteti i Elbasanit, mirëpriti nxënës nga gjimnazi "Dhaskal Todri", për të zhvilluar një orë mësimi të hapur në kuadër të lëndës së Këshillimit të Karrierës. Në takim morën pjesë përfaqësues nga zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, ku ndër të tjera nxënësit u njohën më nga afër me ambientet e universitetit.



### Forumi: "Zhdukja e njerëzve gjatë regjimit komunist"

Universiteti i Elbasanit në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, organizuan për studentët një forum mbi zhdukjen e njerëzve gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

Në fjalën e saj përshëndetëse zëvendësrektorja e Universitetit Prof.as.dr Elvira Fetahu, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe organizimit të aktiviteteve që shërbejnë për të rritur vazhdimisht, jo vetëm cilësinë akademike, por edhe njohjen e studentëve me koncepte, këndvështrime, perspektiva dhe studime të reja që plotësojnë formimin e tyre teorik, praktik dhe kulturor, duke u bërë kështu lajmëtarët më të denjë të ndryshimit të së ardhmes.

### Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së



Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, me të cilën Universiteti i Elbasanit bashkëpunon, zhvilloi një tryezë të rrumbullakët rreth temave: "Gjuha Shqipe dhe sfidat aktuale të saj" dhe "Gjuha standarde shqipe dhe sfidat e përdorimit zyrtar të saj". Në këtë tryezë shkencore morën pjesë personalitete dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Universiteti i Elbasanit u përfaqësua nga zëvendësdekana e Fakultetit të Shkencave Humane, dr. Aurela Basha, e cila mori pjesë me një ligjeratë.

### Gjimnazi "Dhaskal Todri" në UE



Prezantimi i projektit SPINAKER-Heritage, Art and Business Intensive Programme. Drejtuesja e këtij projekti znj. Justyna Dabrowska, pedagoge në Universitetin Ekonomik të Kraków, Poloni, prezantoi për studentët e programeve të ndryshme të studimit, mundësitë dhe avantazhet që ofron ky projekt për formimin akademik dhe kulturor të tyre. Objektivi kryesor i projektit është të rrisë nivelin e ndërkombëtarizimit të universitetit, rritjen e cilësisë së ofertës arsimore ndërkombëtare që përfshijnë elementë të trashëgimisë kulturore dhe artit polak.